



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___/___/2019

V E N D I M

Nr. 92, Datë 08/07/2019

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 5, datë 17.01.2019, e Z. E.J., ku pretendohet diskriminim për shkak të “gjendjes arsimore”, “gjendjes shoqërore”, dhe “përkatësisë në një grup të veçantë”, nga ana Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” (QSUT), Tiranë.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, rezulton se ankuesi E.J. ka punuar në pozicionin “infirmier pavioni”, pranë Polit të Administrimit të Integruar të Spitalit Polivalent, të QSUT-së. Marrëdhënia e punës ndërmjet palëve është mbështetur në Kontratën Individuale të Punës, të lidhur në datën 03.12.2009, e më pas në Kontratën Individuale të Punës, të lidhur në datën 15.05.2012. Në vijim, nëpërmjet Vendimit nr. 891, datë 11.12.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të QSUT-së, është vendosur që ankuesit t’i ndërpriten marrëdhëniet kontraktuale të punës me QSUT, për shkelje të kushteve të kësaj kontrate, përkatësisht nenit 9² të saj, ku parashikohen detyrimet e punëmarrësit, si dhe për shkelje të Kodit të Etikës, së punonjësve të QSUT-së, përkatësisht nenit 4, pika 4.5³ të saj. Referuar vendimit të mësipërm, në respektim të afatit të

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

² Neni 9, i Kontratës Individuale të Punës parashikon: “Punëmarrësi ruan me besnikëri interesat e ligjshme të punëdhënësit”.

³ Neni 4, pika 4.5. e Kodit të Etikës parashikon: “Punonjësi i QSUT nuk duhet të bëjë në publik komente të papërshtatshme, të tilla si: ...deklarata apo opinione personale që mund të interpretohen si zyrtare; sulme kundër administratës ose punonjësve të tjerë të institucionit, etj. Në rastet e daljes në media, ai është i detyruar të marrë më parë konfirmim mbi qendrimin institucional pranë Zyrës së marrëdhënieve me publikun dhe në asnjë rast të shkelë këtë Kod”.

njoftimit, duke filluar nga data e marrjes dijeni, marrëdhënia e punës së ankuesit me QSUT-në, ndërpritet në datën 15.03.2019.

Për sa më sipër, ankuesi E.J. thekson se situata e mësipërme dhe largimi i tij nga puna ka lidhje të drejtpërdrejtë me faktin se ai është Kryetar i Shoqatës së Infermierëve të Shqipërisë dhe nën këtë cilësi ka ngritur zërin në median e shkruar dhe atë elektronike, për të drejtat e infermierëve, lidhur me përmirësimin e kushteve të punës, rritjen e pagave, të cilat janë të ulëta dhe mbi mënyrën diskriminuuese, se si infermierët trajtohen në krahasim me personelin tjetër, shëndetësor.

Z. E.J. shprehet se Shoqata e Infermierëve të Shqipërisë ka nxjerrë njoftim, që në datën 20.12.2018, infermierët do të mbledheshin dhe do të protestonin për të drejtat e tyre para Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Në vijim të njoftimit, ankuesi pretendon se është njoftuar nga strukturat përkatëse të QSUT-së për një takim, në të cilin i është komunikuar që intervista e tij me median e shkruar, mbi kërkesat e infermierëve ka cënuar imazhin e QSUT-së dhe se në kushtet kur, ai është punonjës i QSUT-së nuk mund të bëjë deklaratat pa marrë leje nga strukturat përkatëse të kësaj qendre spitalore. Më pas, ai është njoftuar mbi Vendimin nr. 891, datë 11.12.2018, e Drejtorit të Përgjithshëm të QSUT-së, sipas së cilit Z. E.J. i ndërpritën marrëdhëniet e punës.

Ankuesi e informon Komisionerin se problemet e para me QSUT-në, kanë lindur, kur shoqata, të cilën ai drejton ka kërkuar që infermierët të trajtohen në mënyrë dinjitoze, pasi ata paguanin një tarifë prej 100 lekësh, për parkimin e automjetit të tyre në parkimin e QSUT-së, ndërkohë që mjekët dhe kryeinfermierët nuk e paguanin një tarifë të tillë.

Z. E.J. pretendon gjithashtu se në datën 04.09.2018, QSUT ka bërë kërkesë me shkrim drejtuar Shoqatës Infermierët e Shqipërisë, nëpërmjet së cilës kërkohet informacion mbi shoqatën dhe aktet e regjistrimit të saj në gjykatë. Në këtë kërkesë theksohet fakti se publikimi në rrjetet sociale i disa dokumenteve, nga ana e kësaj shoqate, cënonte interesat ligjore të QSUT-së. Ankuesi pretendon gjithashtu se në vijim ka qenë subjekt i sjelljeve diskriminuuese në ambientet e punës, të cilat kanë ardhur si pasojë e pozicionit të tij të punës si infermier, si dhe pozicionit që ai mban si Kryetar i Shoqatës së Infermierëve të Shqipërisë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 5, datë 17.01.2019, e Z. E.J., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

B. Mbështetur në nenin 33, pika 7⁴, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Drejtorit të Përgjithshëm të QSUT, me shkresën nr. 79/1, datë 24.01.2019, ku kërkohet informacion, si më poshtë vijon:

- Ñ Informacion i plotë, lidhur me pretendimet e Z. E.J.;
- Ñ Kopje e kontratës/ave të punës të lidhura ndërmjet ankuesit dhe QSUT-së;
- Ñ Kopje e njoftimit për zgjidhje të kontratës së punës;
- Ñ Kopje e librezës së punës së ankuesit;
- Ñ Informacion, nëse ndaj ankuesit janë marrë masa disiplinore gjatë kohës që ka punuar pranë QSUT-së.
- Ñ Vlerësime të performancës në punë të ankuesit gjatë periudhës, që ka punuar në QSUT;
- Ñ Kopje e Vendimit nr. 891, datë 11.12.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të QSUT-së;
- Ñ Kopje e Kodit të Etikës për punonjësit e QSUT-së;
- Ñ Vendimi nr. 7, datë 21.09.2015, i Bordit Drejtues të Spitaleve Universitare “Për miratimin e rregullores së funksionimit të QSUT-së;
- Ñ Proçesverbali nr. 5173, datë 07.12.2018;
- Ñ Memo nr. 5173/1, datë 11.12.2018, e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore;
- Ñ Kopje e korrespondencës zyrtare të QSUT-së, me Z. E.J., në cilësinë e Kryetarit të Shoqatës së Infermierëve të Shqipërisë;
- Ñ Çdo informacion tjetër që ka lidhje me çështjen e parashtruar nga ankuesi.

1. Në përgjigje të shkresës nr. 79/1, datë 24.01.2019, të Komisionerit, QSUT dërgoi shkresën nr.79/2, datë 03.03.2019, nëpërmjet së cilës fillimisht e informon Komisionerin mbi ecurinë e marrëdhënieve të punës me ankuesin. Sipas shkresës së sipërpërmendur, marrëdhënia e punës së Z. E.J. me QSUT ka filluar në vitin 2009, ku nëpërmjet Vendimit nr. 396, datë 03.12.2009, të Drejtorit të Përgjithshëm të QSUT-së, ai emërohet në pozicionin e punës “infermier” pranë Shërbimit të Urgjencës Kirurgjikale në QSUT.

Gjatë kohës që, ankuesi ka punuar pranë QSUT, ndaj tij janë marrë 2 (dy) masa disiplinore, përkatësisht masë disiplinore “*vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna*”, në bazë të Vendimit nr. 577, datë 13.10.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të QSUT-së dhe masa disiplinore “*vërejtje*”, në bazë të Vendimit nr. 155, datë 03.02.2017, të Drejtorit të Përgjithshëm të QSUT-së. Në vitin 2017, referuar shkresës së datës 12.05.2017 të depozituar nga mjekja S.B. dhe Shefi i Shërbimit, L.K.,

⁴ Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “*Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër*”.

Drejtoria e Burimeve Njerëzore pranë QSUT-së është informuar për sjellje jo korrekte të punonjësit E.J., kundrejt mjekes, duke arritur deri në kërcënim. Për sa më sipër, ankuesi është njoftuar nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore për takim dhe i është kërkuar të korrigjojë sjelljen e tij me kolegët, gjë të cilën e ka pranuar edhe ai vetë. Në vijim, në verën e vitit 2018, punonjësi ka kryer një postim në rrjetet sociale, ku ofendonte dhe hidhte baltë mbi institucionin dhe kolegët e tij. Punonjësi është njoftuar sërish për takim pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe i është tërhequr sërish vëmendja për komunikimin e tij jo korrekt dhe në shkelje të Kodit të Etikës, si dhe kushteve të Kontratës së Punës së lidhur me QSUT.

Në datën 03.12.2018, në gazetën Shekulli, punonjësi E.J. ka publikuar një artikull, ku citohet: *“Infermierët e diskriminuar, rroga e 13: vetëm atyre që kanë mik.....sipas rregullit, e merr çdo infermier, por në të vërtetë marrin ata që kanë dikë mik. Vitin që kaloi nga Urgjenca e QSUT-së e kanë marrë vetëm tre veta, i përzgjedhi shefi...etj.”*

Për sa më sipër, punonjësi është njoftuar nga strukturat e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, për t’u paraqitur në takim në datën 07.12.2018, ku është mbajtur procesverbali nr. 5173 prot., datë 07.12.2018. Qëllimi i këtij takimi ishte për t’u informuar nëse në lidhje me vërtetësinë e fakteve të parashtruara në këtë artikull. Sikurse reflektohet edhe në procesverbalin e takimit, Z. E.J. është shprehur se ka dëgjuar infermierët (kolegët) , por nuk ka asgjë të verifikuar apo të zyrtarizuar, lidhur me sa është shprehur në gazetë.

Lidhur me pretendimet e Z. E.J., për diskriminim për shkak të “*gjendjes arsimore*”, “*gjendjes shoqërore*”, dhe “*përkatësisë në një grup të veçantë*”, QSUT vë në dukje të Komisionerit se zgjidhja e marrëdhënies së punës me ankuesin është kryer duke respektuar nenin 144 të Kodit të Punës. Menjëherë pas intervistës në Gazetën Shekulli, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, pranë QSUT-së e ka njoftuar Z. E.J. të paraqitet pranë kësaj strukture, për të dhënë shpjegime në lidhje me këtë intervistë. Në takimin e realizuar me punonjësin është mbajtur procesverbali përkatës i nënshkruar nga të gjithë pjesëmarrësit dhe nga vetë ai. Në këtë procesverbal pasqyrohet arsyeja e takimit dhe pretendimet e tij. Pas përfundimit të takimit, në respektim të afateve ligjore, Z. E.J. është njoftuar në lidhje me arsyet e zgjidhjes së kontratës së punës, nëpërmjet Vendimit nr. 891, datë 11.12.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të QSUT-së, duke argumentuar shkaqet e zgjidhjes së kontratës, respektimin e afatit të njoftimit të parashikuar nga neni 143 i Kodit të Punës, përfitimin e të drejtës për të kryer lejen vjetore të vitit 2018, përfitimin e së paku 20 orëve leje të parapagueshme në javë sipas nenit të sipërpërmendur, si dhe shpërblimin për vjetërsi në punë në zbatim të nenit 145 të Kodit të Punës. Në këtë mënyrë, në shkresën e QSUT-së theksohet fakti se zgjidhja e kontratës së punës është kryer në respektim të të gjithë procedurës së parashikuar nga Kodi i Punës dhe nuk ekziston asnjë shkak diskriminues.

Për sa i përket shkakut për zgjidhjen e kontratës së punës, QSUT sqaron se Z. E.J. është shprehur në intervistën e dhënë në gazetën Shekulli, si vijon: *“Infermierët të diskriminuar: Rroga e 13 vetëm atyre që kanë mik”*. Në vijim, në procesverbalin e takimit të datës 07.12.2018, ankuesi ka

mohuar të ketë qenë në dijeni të këtij informacioni, por është shprehur se informacioni vinte nga burime jo të sigurta, nga fjalë që qarkullonin nga stafi infermieror, fakt që e rëndoi situatën, duke e bërë sjelljen e tij jo etike, në kundërshtim me rregullat dhe fyese për institucionin. Në shkresë theksohet fakti se QSUT është një qendër terciare, më e madhja në vend, ku punohet çdo ditë për të fituar dhe mbajtur besimin e publikut dhe të pacientëve të saj. Në shkresë sqarohet se nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Drejtoria Ekonomike e QSUT-së, përkatësisht aktet vijuese: Vendimi nr. 68, datë 19.12.2018, i Këshillit Administrativ, Urdhër nr. 350, datë 29.12.2017, i Drejtorit të Përgjithshëm të QSUT-së, si dhe Vendimit nr. 72, datë 29.12.2017, të Këshillit Administrativ dhe Urdhërit nr. 354, datë 29.12.2017, të Drejtorit të Përgjithshëm të QSUT-së, rezulton se shpërblimet e dhëna për stafin e QSUT-së janë shpërndarë në bazë të meritave, duke vlerësuar punën e 12 muajve të çdo shërbimi, si dhe duke përzgjedhur si përfitues të shpërblimit, shërbimin që ka patur fluks më të madh pune, si dhe duke vlerësuar performancën e shërbimit. Përgjedhja nuk ka qenë individuale, por në grup (si shërbim), duke përfituar që nga Shefi i Shërbimit, mjekët, infermierët dhe sanitarët.

Në shkresën e QSUT-së theksohet gjithashtu fakti se arsyeja kryesore e takimit të datës 07.12.2018, ka qenë vetëm evidentimi i pavërtetësisë së informacionit të dhënë nga ankuesi, informacion, i cili ka patur si qëllim denigrimin dhe dëmtimin e imazhit të QSUT-së. Në intervistën e dhënë, ankuesi është shprehur për informacione, që kanë të bëjnë me QSUT-në dhe jo për mbrojtjen e interesave të infermierëve anëtarë të shoqatës, të cilët mund të mos jenë të punësuar pranë QSUT-së, por edhe në spitale të tjera. QSUT thekson faktin se Z. E.J. nuk ka folur në terma të përgjithshëm, apo për trajtimin e një problematike, që përfshin të gjithë infermierët, por në thelb, ai ka folur, sepse nuk ka qenë përfitues i shpërblimit të fundvitit, gjë e cila nuk varet as nga Shefi i Shërbimit dhe as nga Drejtoria e QSUT-së, por vetëm nga performanca e çdo shërbimi.

Në shkresën e sipërpërmendur theksohet fakti se Z. E.J. ka thyer besimin tek punëdhënësi, duke bërë që ndaj tij të merren masa ekstreme. Ky vendim nuk ka ardhur vetëm si rrjedhojë e veprimeve në kundërshtim me Kodin e Etikës, por edhe duke vlerësuar të gjithë performancën e ankuesit në të gjithë vitet e punës. Punëmarrësi, gjatë marrëdhënies së punës, ka marrë dy vërejtje me shkrim, të cilat janë përmendur më sipër, si dhe ka reflektuar sjellje kërcënuese ndaj kolegëve, për të cilën i është tërhequr vëmendja. Gjithashtu ankuesit i është tërhequr vëmendja edhe herë të tjera, për shkak se ka patur sjellje jo korrekte me kolegët gjatë orarit të punës. Vendimi nr. 891, datë 11.12.2018, i Drejtorit të Përgjithshëm të QSUT-së, nuk reflekton asnjë veprim diskriminues ndaj ankuesit. Zgjidhja e marrëdhënieve të punës ka ardhur si pasojë e veprimeve të Z. E.J., në kundërshtim me Kodin e Punës, Kodin Etik dhe Kontratën Individuale të Punës.

QSUT shprehet se për dhënien e intervistës, Z. E.J., i cili ndodhej në cilësinë e punëmarrësit, ka patur detyrimin ligjor të marrë miratimin nga punëdhënësi, detyrim, të cilin nuk e ka zbatuar. Ai duhet të informonte në lidhje me qendrimin, që do të shprehte, për të shmangur dhënien e

lajmeve të pavërteta dhe të pafaktuara, të cilat dëmtojnë imazhin e QSUT-së. Mosrespektimi i rregullave ka sjellë si pasojë, jo vetëm dhënien e lajmeve të rreme, duke ngritur një akuzë publike për drejtuesit e institucionit, por është edhe në shkelje të Kodit të Etikës së QSUT-së, i cili parashikon, si vijon:

Neni 4 “*Ruajtja e informacionit dhe komunikimi me publikun*”: “*Punonjësi i QSUT-së nuk duhet të bëjë në publik komente të papërshtatshme, të tilla si:...deklarata apo opinione personale që mund të interpretohen si zyrtare; sulme kundër administratës ose punonjësve të tjerë të institucionit etj. Në rastet e daljes në media, ai është i detyruar të marrë më parë konfirmim mbi qendrimin institucional pranë zyrës së marrëdhënieve me publikun dhe në asnjë rast të shkelë këtë Kod.*”

Neni 13 “*Dispozita të tjera*”: “*b. Sjelljet që nuk janë të përmendura në nenet e këtij Kodi, mund të konsiderohen gjithësesi si cënim i rregullave të etikës, nëse vlerësohet se ndikojnë në besimin e publikut dhe reputacionin e institucionit*”.

C. Në vijim të ndjekjes së procedurave të shqyrtimit administrativ, palët u njoftuan për seancë dëgjimore, e cila u vendos të realizohet në datën 15.04.2019, ora 12:00, pranë Zyrës së KMD-së.

Në seancë dëgjimore u paraqit ankuesi E.J. dhe përfaqësuesja e QSUT-së, Znj. E. M., e cila depozitoi Autorizimin nr. 502/15, datë 12.04.2019, e Drejtorit të Përgjithshëm, të QSUT-së, nëpërmjet së cilit autorizohet për pjesëmarrje në seancë dëgjimore.

Ankuesi parashtroi pretendimet e tij për diskriminim para përfaqësuesve të Komisionerit, duke sqaruar se para 3 vitesh, është kryer një transferim i tij nga Reparti i Urgjencës së QSUT-së tek Reparti Endokrinologjisë. Ai shprehet se nuk ka punuar asnjë ditë në këtë repart, por me shpresë zyrtare rezulton se ka punuar 5 ditë pranë Repartit të Endokrinologjisë. Kjo lëvizje, sipas tij është kryer pasi ai ka qenë mbrojtës i të drejtave të infermierëve. Njëkohësisht, ankuesi përmend edhe një episod tjetër, i cili ka lidhje me një fatkeqësi familjare të tij, humbjen e vajzës së tij, para një viti e gjysëm, e cila trajtohej në një nga repartet pranë QSUT-së. Lidhur me këtë rast, ai thekson faktin se në asnjë moment nuk është trajtuar si koleg brenda QSUT-së, si dhe kur ka pyetur mjekun përgjegjës, ky i fundit është shmangur për t'i dhënë përgjigje. Pas ngjarjes së dhimbshme, ankuesi shprehet se ka reaguar si çdo prind që mund të gjendet para një situatë të tillë, fakt që është keqpërdorur nga QSUT.

Z. E.J. sqaron se ka krijuar Shoqatën e Infermierëve në vitin 2016 dhe është kryetar i kësaj shoqate. Në këtë shoqatë ka patur mjaft ankesa nga infermierët, të cilët ndiheshin të pavlerësuar në pagë dhe në pozicionin e tyre në punë. Z. E.J. u shpreh se ka bërë përpjekje, që infermierët të kishin paga më të mira, të ndiheshin të vlerësuar në punën e tyre, si dhe të kishin një pozicion të respektuar. Në këtë kontekst, ai përmendi çështjen e sigurimit të parkimit kundrejt pagesës prej 100 lekësh, të automjeteve të infermierëve, brenda vend parkimit të QSUT-së, çështje për të cilën shoqata, të cilën ai drejton ka bërë shumë përpjekje, në mënyrë që infermierët që punojnë pranë QSUT-së ta përfitonin falas, por një

gjë e tillë nuk u arrit kurrë. Për këtë çështje është kryer protestë e infermierëve, të organizuar nga shoqata e drejtuar nga ankuesi.

I pyetur se si është vlerësuar performanca e tij në punë, ankuesi u shpreh se asnjëherë nuk ka patur vlerësim të performancës në punë pranë QSUT-së. Ndër të tjera, ai u shpreh se është kontaktuar nga strukturat përgjegjëse të QSUT-së, për të tërhequr një zarf pranë tyre dhe në këtë mënyrë është vënë në dijeni të zgjidhjes së marrëdhënies së punës. Në vijim, ankuesi sqaron se ka depozituar shkresë zyrtare për anulimin e vendimit për largim nga puna dhe nga ana e QSUT-së i është kthyer përgjigje, që vendimi nuk mund të anulohet, pasi ai ka kryer shkelje.

Njëkohësisht, Z. E.J. theksoi faktin se në cilësinë e Kryetarit të Shoqatës së Infermierëve të Shqipërisë ka lëshuar disa deklarata dhe ka dhënë disa intervista në median e shkruar, për mbrojtjen e të drejtave të infermierëve, por në asnjë rast nuk është paralajmëruar nga strukturat përgjegjëse të QSUT-së, që ai s' duhet ta bënte një gjë të tillë. Njëkohësisht, ankuesi theksoi faktin se ka kërkuar leje për të kryer një protestë në datën 20 dhjetor 2018, por një leje e tillë nuk iu dha nga organet e policisë së shtetit.

Përfaqësuesja e QSUT-së u shpreh se shkak për zgjidhjen e marrëdhënies së punës me ankuesin ka qenë intervista e dhënë nga ana e tij në gazetën Shekulli. Për zgjidhjen e marrëdhënies të punës janë marrë parasysht edhe masat disiplinore të mëparëshme, të dhëna për Z. E.J.. E pyetur në lidhje me mënyrën se si kryhet vlerësimi i performancës në punë, përfaqësuesja e QSUT-së u shpreh se aktualisht vlerësimi në punë, kryhet sipas një formulari të posaçëm, ndërkohë që për periudhat e mëparëshme, ajo nuk kishte dijeni se si është kryer një vlerësim i tillë. Ajo u shpreh se intervista e dhënë nga Z. E.J. në gazetën Shekulli ka qenë një intervistë e nisur nga interesa personale dhe nuk kishte lidhje me mbrojtjen e interesave të infermierëve. Informacioni i dhënë nga ana e tij në këtë gazetë nuk ka qenë i saktë.

Ankuesi u shpreh se në momentin e intervistimit të tij, nga gazetarët e Gazetës Shekulli, kanë qenë të pranishëm edhe infermierë të tjerë, të cilët kanë folur, sikurse edhe ai. Në këtë kontekst, ai pyet se përse masa për largim nga puna është ndërmarrë vetëm për të dhe jo për të tjerët. Ai u shpreh se informacionet i ka marrë nga infermierët e tjerë dhe se nuk ka patur asgjë personale në dhënien e kësaj interviste. Ndër të tjera, ai u shpreh se ka patur veprime tendencioze ndaj tij, dhe shkak për këtë është fakti se ai ka kërkuar për t'u rikthyer në pozicionin e tij të punës pranë Repartit të Urgjencës së Kirurgjisë pranë QSUT-së, pasi ai ka krye një master shkencor, si dhe ka kryer një sërë trajnimesh në fushën e kirurgjisë. Përfaqësuesja e QSUT-së u pyet nëse ankuesit i është dërguar njoftim për ndërprerjen e marrëdhënies të punës dhe ajo u përgjigj se ankuesit i është komunikuar direkt Vendimi nr. 891, datë 11.12.2018, i Drejtorit të Përgjithshëm të QSUT-së dhe nuk ka patur njoftim paraprak.

- Në vijim të seancës dëgjimore, Komisioneri iu drejtua QSUT-së me anë të shkresës nr. 79/3, datë 08.05.2019, ku kërkoi informacionin e mëposhtëm:

1. Kopje të formularëve të vlerësimeve të performancës në punë të Z. E.J., gjatë viteve që ka punuar pranë QSUT-së;
2. Kopje e Njoftimit për ndërprerje të marrëdhënieve të punës, drejtuar ankuesit;
3. Informacion mbi faktin, nëse edhe ndaj punonjësve të tjerë të QSUT-së, të cilët, sikurse Z. E.J., kanë qenë pjesë e intervistës së dhënë në Gazetën Shekulli, në datën 03.12.2018, janë marrë masa disiplinore analoge, me atë që është marrë ndaj ankuesit;
4. Cili ka qenë reagimi i strukturave përgjegjëse të QSUT-së, ndaj intervistave të tjera të dhëna nga Z. E.J., në median e shkruar, mbi problematika që kanë lidhje me përmirësimin e statusit dhe mbrojtjen e të drejtave infermierëve në QSUT dhe më gjerë?
5. A është vënë paraprakisht në dijeni ankuesi, nga strukturat përkatëse të QSUT-së, se mbështetur në përcaktimet e nenit 4, të Kodit të Etikës së Punonjësve të QSUT-së, nuk duhet të japë intervista në median e shkruar dhe atë vizive, në lidhje me çështje, për të cilat duhet të marrë më parë konfirmimin e këtij institucioni? Nëse po, të dërgohet akti administrativ përkatës, nëpërmjet së cilit është kryer njoftimi i ankuesit.
6. A është dhënë edhe më parë konfirmim nga strukturat përgjegjëse të QSUT-së, për Z. E.J., në lidhje me intervista të tjera të dhëna nga ana e tij në median e shkruar? Nëse një konfirmim i tillë nuk është dhënë, cili është qendrimi i mbajtur në vijim nga QSUT?
 - Në përgjigje të shkresës nr. 79/3, datë 08.05.2019, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë dërgoi shkresën nr. 79/4, datë 16.05.2019, nëpërmjet së cilës informon si më poshtë vijon:

Lidhur me çështjen e parë, të parashtruar nga KMD, QSUT informon se në dosjen e Z. E.J. nuk ka asnjë formular vlerësimi në punë.

Lidhur me çështjen e tretë, QSUT informon se shkresat e ardhura nga Shoqatat e Infermierëve nuk janë të administruara nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore.

Lidhur me çështjen e katërt, QSUT informon se publikimet në media parashikohen në Kodin Etik të QSUT-së, Neni IV “Ruajtja e informacionit dhe komunikimi me publikun”, pika 4.5: “Punonjësi i QSUT-së nuk duhet të bëjë në publik komente të papërshtatëshme, të tilla si: vërejtje mbi politikën ose programe të institucionit; deklarata apo opinione personale që mund të interpretohen si zyrtare; sulme kundër administratës ose punonjësve të tjerë të Institucionit, etj. Në rastet e daljes në media, ai është i detyruar të marrë më parë konfirmim mbi qendrimin institucional pranë Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun dhe në asnjë rast të shkelë këtë Kod”. Për rastin e publikimit jo etik të Z. E.J., në rrjetet sociale (FB), në verë 2018, ai është thirrur në

Zyrën e Drejtorit të Burimeve Njerëzore në prezencën e Zv. Drejtorit të Përgjithshëm dhe i është tërhequr vëmendja verbalisht për shkelje të Kodit Etik, përkatësisht për pikën, që lidhet me publikimet zyrtare.

Lidhur me çështjen e pestë, QSUT informon se lidhur me publikimet e Z. E.J. në media, nuk rezulton asnjë kërkesë e administruar për publikime, nga ana e tij si infermier i QSUT-së.

Bashkëlidhur shkresës së sipërpërmendur, QSUT ka dërguar shkresën nr. 5266, datë 03.12.2009, Vendimin nr. 891, datë 11.12.2018, e Drejtorit të Përgjithshëm të QSUT-së dhe Memon nr. 5173/1, datë 11.12.2018 “*Relacion për punonjësin E.J.*”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës nr. 5, datë 17.01.2019, së Z. E.J., Komisioneri jep vlerësimin dhe gjykimin e tij, vetëm për ato çështje, të cilat bëjnë pjesë në kompetencat, që këtij institucioni, i atribuohen nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë.

Ankuesi E.J. ka qënë në marrëdhënie pune me Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, që prej datës 03.12.2009, kur ndërmjet palëve është lidhur Kontrata Individuale e Punës, me afat të pacaktuar, e cila është rinovuar në vijim në datën 15.05.2012.

Z. E.J. ka punuar në disa pozicione pune në pavione të ndryshme të QSUT-së dhe pozicioni i fundit i punës, që ka mbajtur në këtë institucion mjekësor, ka qënë Infermier Pavioni pranë Polit të Administrimit të Integruar të Spitalit Polivalent. Përveç pozicionit të punës si infermier pranë QSUT-së, Z. E.J. që prej fundit të vitit 2016 e në vijim ka mbajtur edhe pozicionin e kryetarit të “Shoqatës së Infermierëve të Shqipërisë”. Shoqata në fjalë është e regjistruar si personi juridik, nëpërmjet Vendimit nr. 5489, datë 02.12.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Referuar vendimit të sipërpërmendur, citohet” *Objektivat bazë të Shoqatës janë: monitorimi i zhvillimit të disiplinave shkencore dhe profesionale të infermierëve, integrimi dhe përmirësimi i trajnimit shkencor dhe profesional të infermierëve në bashkëpunim me universitetet dhe institucionet e tjera, në bashkëpunim me shoqatat e tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe mbrojtjen e infermierëve, kur atyre u shkelen të drejtat e tyre*”. Një parashikim i tillë gjendet edhe në nenin 6, të Aktit të Themelimit të Shoqatës së Infermierëve të Shqipërisë, miratuar në datën 04.11.2016 nga të gjithë anëtarët themelues, si dhe në Pjesën III, nenin 7, të Statutit të kësaj shoqate.

Pikërisht në referencë të parashikimeve të bëra në aktet e mësipërme, Shoqata e Infermierëve të Shqipërisë ka vepruar në mbrojtje të të drejtave të infermierëve, duke filluar që nga deklaratat

dhe intervistat në shtypin e shkruar dhe atë viziv, e deri në përpjekjet për zhvillimin dhe organizimin e protestave të ndryshme. Kështu gjatë vitit 2017, Shoqata e Infermierëve të Shqipërisë e kryesuar nga Z. E.J. ngriti zërin në lidhje me çështjen e pagesës së vendparkimit brenda QSUT-së, për automjetet e infermierëve⁵, në kushtet kur kjo pagesë nuk aplikohet për kryeinfermierët dhe mjekët. Referur kërkesës së datës 17.08.2018, së kësaj Shoqate, drejtuar Rajonit të Policisë nr. 4, në Tiranë, rezultoi se në muajin gusht 2018, do të kryhej protestë paqësore në hyrje të QSUT-së, si kundërpërgjigje e tarifave të parkimit për infermierët. Ky problem u bë madhor pas fillimit të procedimit pranë institucionit të Avokatit të Popullit, i cili nëpërmjet shkresës nr K1/SH 34-10 prot, datë 23.11.2017, i rekomandoi QSUT-së përjashtimi nga tarifa e pagesës për parkim të rreth 300 infermierëve në territorin e QSUT-së.

Referuar provave të depozituara pranë Komisionerit, rezultoi se Z. E.J., në cilësinë e kryetarit të kësaj shoqatë ka dhënë disa intervista, në mbrojtje të të drejtave të infermierëve. Në këtë kontekst, përmendim artikullin *“Ulje pagash për 4 mijë infermierë, E.J.: Do i drejtohem gjykatës”*, botuar në Gazetën Shqiptare, të datës 30.06.2018; artikullin në Faxweb.al *“Diplomat e infermierëve, reagon kryetari i Shoqatës: Do u mbahen nga 50 mijë lekë...”*, artikulli *“Bluzat e bardha drejt Gjermanisë, 2 mijë të larguar brenda 6 muajsh...”* i publikuar në Balkanweb.com, në bazë të intervistës së dhënë nga Z. E.J.; intervista dhënë në Shqiptarja.com *“Protestë për parkimin në QSUT, infermierët: Konkensionari po na merr...”*; intervista e botuar në www.koha.jonë.com *“Diploma u ul pagat dhe fut në borxh 4 mijë infermierë, mblidhen firmat..”*; intervista e botuar në Shekulli.com.al *“E.J.: 10 fakultetet e infermierisë, 10 kurrikula të ndryshme”*, intervistë e dhënë në 1 shkurt 2018, *“Punësimi i infermierëve”* në Scan Television etj.

Në vijim të sa më sipër, në datën 03.12.2018, Z. E.J. jep intervistë për gazetën Shekulli, ku citohet: *“...kreu i Shoqatës së Infermierëve dhe njëkohësisht infermier pranë QSUT-së, E.J. u shpreh se këtë pagë e marrin vetëm ata që kanë një ‘mik të fortë’. ‘Sipas rregullit, e merr çdo infermier, por në të vërtetë e marrin ata që kanë dikë mik. Kjo nuk është e drejtë. Vitin që kaloi, te Urgjenca e QSUT-së e kanë marrë vetëm 3 veta, i përzgjedhi shefi, ku një nga ata ishte kryeinfermieri dhe 2 të tjerë infermierë. Disa herë është dhënë vetëm 10 000 lekë të reja dhe pse thuhet që shpërblimi të jetë një pagë e plotë” tha ai*”.

Përveç Z. E.J., në këtë intervistë rezultoi të jenë shprehur edhe disa infermierë të tjerë, që punojnë në Urgjencën e Kirurgjisë, sikurse citohet: *“Infermierët që punojnë në Urgjencën e Kirurgjisë, thanë për gazetën Shekulli se shpërblim kanë marrë vetëm kryeinfermierja dhe 2*

⁵ Shoqata e Infermierëve të Shqipërisë ka depozituar ankesën nr. 90, datë 02.07.2018, pranë KMD-së, lidhur me çështjen në fjalë. Me anë të vendimit nr. 146, datë 02.07.2018, KMD ka vendosur mospranimin e ankesës, pasi ishte depozituar jashtë afatit ligjor, të përcaktuar në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*;

infirmierë, ku njëri sipas tyre, bën sekserin e shefit dhe tjetri është patriot i tij. Shefi i Urgjencës është Dr. M. K., shef J. J., kryeinfirmierër A. B. dhe infirmier A.S.”

Në të njëjtin artikull citohet: *“Një tjetër infirmier i kontaktuar nga gazeta Shekulli, është edhe G.H. Në fjalën e tij ai tha se prej 10 vitesh si infirmier, asnjëherë nuk e ka marrë rrogën e 13-të. “Është dhënë vetëm ndonjë shpërblim, prej 5 mijë lekë të reja, i cili nuk është dhënë për të gjithë ky shpërblim varet nga Drejtoria, pasi ajo cakton se kush do shpërblehet. Në bazë të performancës dhe fluksit të punës jepet. Zakonisht urgjencës dhe pavionit të Reanimacionit ose Psikiatrisë. Vitin që kaloi ka marr vetëm urgjenca për herë të parë. Historikisht është bërë kërkesa, por nuk të dëgjon askush. Ne aty kemi bërë kërkesë për shumë probleme dhe duhet të kesh mik që të plotësohet””.*

Në vijim të takimit të zhvilluar nga përfaqësuesit e QSUT-së në datën 07.12.2018, si dhe në bazë të Memos nr. 5173/1, datë 11.12.2018, të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, ndaj Z. E.J. merret Vendimi nr. 891, datë 11.12.2018, i Drejtorit të Përgjithshëm të QSUT-së, nëpërmjet së cilit është vendosur, që ankuesit t’i ndërpriten marrëdhëniet kontraktuale të punës me QSUT, për shkelje të kushteve të kësaj kontrate, përkatësisht nenit 9, të saj, ku parashikohen detyrimet e punëmarrësit, si dhe për shkelje të Kodit të Etikës, së punonjësve të QSUT-së, përkatësisht nenit 4, pika 4.5, të saj. Referuar vendimit të mësipërm, marrëdhënia e punës së ankuesit me QSUT-në, ndërpritet në datën 15.03.2019. Zgjidhja e kontratës së punës ndërmjet QSUT-së dhe ankuesit është kryer pas dy masave disiplinore që janë marrë ndaj tij, të cilat kanë qenë të shup’ara, në momentin e miratimit të Vendimit nr. 891, datë 11.12.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të QSUT-së.

Për sa më sipër, në nenin 4, pika 4.5., të Kodit të Etikës parashikohet: *“Punonjësi i QSUT nuk duhet të bëjë në publik komente të papërshtatshme, të tilla si: deklarata apo opinione personale që mund të interpretohen si zyrtare; sulme kundër administratës ose punonjësve të tjerë të institucionit, etj. Në rastet e daljes në media, ai është i detyruar të marrë më parë konfirmim mbi qendrimin institucional pranë Zyrës së marrëdhënieve me publikun dhe në asnjë rast të shkelë këtë Kod”.*

Në kontekstin e çështjes në shqyrtim, Komisioneri gjykon se përmbajtja e nënvizuar e nenit 4, pika 4.5., të Kodit të Etikës, në vetvete ka një kontradiktoritet, pasi presupozohet që Z. E.J. apo cilido person, i cili është pjesë e një organizate me interesa legjitime, që ngre zërin në median e shkruar apo atë vizive, për të të mbrojtur drejtat e infirmierëve, apo që i bën oponencë qendrimëve të QSUT-së, *“duhet të marrë më parë konfirmim mbi qendrimin institucional pranë Zyrës së marrëdhënieve me publikun”.* Për sa më sipër, është mëse e kuptueshme, që një konfirmim i tillë nuk do të jepet kurrë nga strukturat përkatëse të QSUT-së.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, Komisioneri ka konstatuar se ekziston një ndërthurje e detyrimeve të Z. E.J., në cilësinë e punëmarrësit ndaj QSUT-së dhe detyrimeve të tij, në cilësinë e kryetarit të

Shoqatës së Infermierëve të Shqipërisë, ndaj kategorisë së infermierëve. Komisioneri gjykon se, në kushtet kur, Z. E.J. ka qenë i lidhur kontraktualisht në marrëdhënie pune me QSUT-në, ka patur detyrim ligjor të zbatojë dispozitat e kontratës individuale së punës, si dhe të akteve të tjera nënligjore, të cilat kanë funksion rregullator të marrëdhënieve etike ndërmjet punëmarrësve dhe QSUT-së. Ndërkohë që, në cilësinë e kryetarit të Shoqatës së Infermierëve të Shqipërisë, ai ka patur dhe ka detyrim të llojë për interesat e infermierëve të Shqipërisë, si dhe të mbrojtë të drejtat e tyre. Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se Z. E.J. duhet të balancojë detyrimet që rrjedhin nga dy pozicionet që ai mban, duke kryer një ekuilibrim ndërmjet tyre. Komisioneri ka konstatuar gjithashtu se zgjidhja e kontratës së punës për Z. E.J. ka ardhur në një moment, pasi ai ka kryer një aktivitet të dendur, sikurse rezultoi edhe më sipër, në median e shkruar dhe atë vizive, për mbrojtjen e të drejtave të infermierëve, e sidomos për ata infermierë që punojnë në QSUT. Në intervistën e dhënë në Gazetën Shekulli, Z. E.J. është shprehur gjithashtu si vijon: *“Ne një pyetje kemi: Pse nuk caktohet një fond për të stimuluar infermierët me një pagë shtesë ose edhe sikur 10 mijë lekë të reja, jo vetëm shpërblim selektiv?.....Ky është diskriminim, pasi çdo infermier kontribuon për jetën e pacientëve...”*. Në këtë kontekst rezulton se qëllimi i intervistës së dhënë në këtë gazetë nuk ka qenë thjesht mbrojtja e të drejtave dhe interesit personal, por mbrojtja e tërësisë së të drejtave të infermierëve të QSUT-së. Komisioneri gjykon se mendimi dhe opinionimi i shprehur nga ana e tij në këtë intervistë, në cilësinë e drejtuesit të shoqatës së Infermierëve të Shqipërisë, e ka penalizuar ankuesin, deri në largim nga puna, duke e ekspozuar ndaj një qendrimi të padrejtë dhe disfavorizues. Njëkohësisht, KMD ka konstatuar se qendrimi i mbajtur ndaj Z. E.J., nga ana e QSUT-së, ka qenë i ndryshëm nga qendrimi i mbajtur ndaj Z. G.H. apo infermierëve të Urgjencës së Kirurgjisë, të cilët sërisht kanë “kritikuar” QSUT-në nëpërmjet thëniesve të tyre në intervistë. I vetmi i penalizuar nga intervista e dhënë në datën 03.12.2018, në Gazetën “Shekulli” ka qenë Z. E.J., ndërkohë që personat e tjerë që janë intervistuar nuk janë proceduar disiplinarisht.

Në këtë aspekt, referuar Aktit të Themelimit të Shoqatës së Infermierëve të Shqipërisë, Komisioneri ka konstatuar se Z. G. H., është një ndër themeluesit e kësaj shoqate. Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se roli i tij është i rëndësishëm dhe pavarësisht këtij fakti edhe pse ka qenë punonjës i QSUT-së dhe ka shprehur qendrimin e tij në lidhje me dhënien e shpërblimeve ndaj infermierëve, nuk është proceduar disiplinarisht, sikurse ankuesi. Në këto kushte, Komisioneri gjykon se QSUT ka vepruar me dy standarde, duke mos mbajtur të njëjtin qendrim, për të njëjtat shkelje, për persona apo punonjës të ndryshëm.

Neni 3, pika 8, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” parashikon shprehimisht: *“Viktimizimi” është trajtim i disfavorshëm apo pasojë negative, që vjen si reagim ndaj një ankimi a një procedimi që synon zbatimin e parimit të barazisë.*”

Në rastin konkret, Komisioneri gjykon se si pasojë e reagimit të Z. E.J., në intervistën e dhënë në gazetën Shekulli, në datën 03.12.2018, nëpërmjet së cilës ai ka synuar mbrojtjen e parimit të barazisë, në dhënien e shpërblimeve nga ana e QSUT-së, për infermierët që punojnë në këtë

institucion mjekësor, ai është viktiminuar deri në zgjidhje të kontratës së punës. KMD vlerëson se zgjidhja e marrëdhënieve të punës me Z. E.J., nuk është e lidhur vetëm me intervistën e dhënë sa më sipër, por me të gjithë aktivitetin e tij, në cilësinë e kryetarit të Shoqatës së Infermierëve të Shqipërisë.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 1, nenin 3, pika 8, nenin 7, pika 1, nenet 12-13, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pika 4, gërma dh), si dhe pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit në formën e viktimizimit të Z. E.J., nga ana Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

Fusha- punesim

Shkak - “*gjendja arsimore*”, “*gjendja shoqërore*”, dhe “*përkatësia në një grup të veçantë*”